

Miratohet vendimi/ Rriten pagat për mjekët dhe infermierët



Paga për mjekët specialistë në strukturat e spitaleve dhe të poliklinikave në të gjithë vendin do të rritet me 50.000 lekë në muaj. Do të ketë një rritje me 7% për mjekët, infermierët dhe teknikët e shkencave mjekësore në të gjithë sistemin parësor dhe atë spitalor, ndërkohë që do të ketë edhe një rritje për të gjithë punonjës në administratat e njësive vendore të kujdesit shëndetësor, të agjensive të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të spitaleve, me një rritje që do të jetë nga 25% deri në 50%. Nga plani 2-vjeçar i rritjes së pagave përfitojnë rreth 22 mijë profesionistë të shëndetësisë në të gjithë vendin.



RAMA-MANASTIRLIU INSPEKTOJNË PUNIMET NË MATERNITETIN "MBRETËRESHA GERALDINË"

Me projektin për rikonstruksionin dhe zgjerimin e maternitetit "Mbretëresha Geraldinë" po ndërhyhet në tre plane: Ndërtimi i ri me 3 kate dhe një kat nëntokësor; Rikonstruksioni i plotë i godinës historike që do ruajë detajet e arkitekturës unike të stilit litoral në fasadën e saj por dhe në hapësirat e brendshme të kësaj godine; si dhe zgjerimi i objektit ekzistues të Obstetrikës. Ky investim është një kантиer i madh prej mbi 6 mijë metër katror, ku pjesën kryesore e zë godina e re, që përfshin shërbimet e laboratorit, imazherisë, urgjencës, Qendrën e Gruas si dhe dy shërbimet e Obstetrikës dhe Gjinekologjisë.

FUQIZOHET FLOTA E IMAZHERISË NË SPITALIN PEDIATRIK NË QSUT

Flota e imazherisë në Spitalin Pediatrik në QSUT është pajisur me skaner, grafi dhe echo, aparatura të teknologjisë bashkëkohore. Teksa kanë vlerësuar këtë investim, mjekët janë shprehur se aparaturat e reja do të rrisin cilësinë në përcaktimin e diagnozës. Sipas mjekëve, aparaturat kanë një rrezatim më të vogël për fëmijët, për më shumë cilësi dhe siguri për shëndetin e pacientëve të vegjël. Ky investim në Spitalin Pediatrik vjen pas investimit madhor të ndërtimit të spitalit të ri të Urgjencës, Terapisë Intensive dhe Kirurgjisë Infantile, i cili po pasohet nga faza e dytë e investimit transformues në korpusin pediatrik, që është rehabilitimi i plotë i Pediatrisë së Specialiteteve.



ZGJEROHET SHËRBIMI I HEMODINAMIKËS TEK "SHEFQET NDROQI"

Shërbimit të Kardiokirurgjisë në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi", do të hapet për herë të parë edhe shërbimi i urgjencës për trajtimin e sindromit koronar-akut. Përveç shërbimit 24/7 në QSUT, shërbimi i urgjencës për interventet kardiake do të jetë 24 orë çdo ditë të hënë në Spitalin "Shefqet Ndroqi" si dhe do të priten urgjencat çdo ditë në fashën orare 07:00 – 15:00 për Sindromën Koronar Akut për qytetarët që kanë indikacion urgjent për të kryer angiografi/angioplastikë sipas zonave të mbulimit të referuar nga urgjenca kombëtare.

PËRFUNDON INVESTIMI NË POLIKLINIKËN E GJIROKASTRËS

Në Spitalin Rajonal Gjirokastrë ka përfunduar projekti për rehabilitimin e Poliklinikës, laboratorit dhe pajisjes me aparatura të reja mjekësore. Janë

14 shërbime dhe specialitete të ndryshme që ofron poliklinika, të rehabilituara sipas standardeve bashkëkohore. Pas Poliklinikës, investimi i radhës do të jetë rehabilitimi i godinës qendrore të Spitalit të Gjirokastrës.



PËRFUNDON FAZA E PARË E INVESTIMIT NË QENDRËN E GJAKUT

Transformimi i qendrës së dhurimit dhe bankës të gjakut me pajisje të teknologjisë së lartë, rikonstruksion i plotë i godinës, por edhe riorganizim i shërbimeve, janë të parashikuara në investimin që pritet të përfundojë brenda këtij viti në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Ndërhyrja e plotë në strukturën e godinës, do të mundësojë ngritjen e një qendre dinjitoze dhe bashkëkohore të cilësisë të lartë, e cila do të plotësohet me shërbimet laboratorike, të përpunimit dhe menaxhimit të bankës së gjakut, sipas standardeve evropiane. Investimi në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut do të rrisë edhe kapacitetet e burimeve njerëzore të shërbimit shëndetësor, por edhe do të çojë në një tjetër nivel edhe kërkimin shkencor në këtë fushë.

